



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 230/prot  
2

Gramsh, më 31.01/2023

**Vendim**

Nr. 02, dt. 30.01.2023

**Për**

**Miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për disa familje në nevojë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.**

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30.01.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje , Transporteve, Strehimi dhe Emergjencave Civile “Për miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për disa familje në nevojë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore”, në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr.459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit,mënyrën e financimit të subvencionit,monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin”,në Udhëzimin e MFE,nr.31,dt.18.11.2019,“Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015,“Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;

**Vendos i:**

- I. Të miratohet kërkesa për 30 familje në nevojë për bonus të qirasë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
- II. T’i propozohet Ministrisë përgjegjëse për strehimin alokimi i fondeve në shumën 3 312 324 sipas tabelës bashkëlidhur.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë,drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile,drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini  
Konf.G.Lena  
Dosja: \_\_\_\_\_  
Afati: \_\_\_\_\_

Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Greta LENA

